

# ***Juridiksioni Gjyqësor Civil sipas së Drejtës Procedurale Civile dhe Administrative***

Anila Karanxha\*

## **Abstrakt**

*Qëllimi i këtij punimi është që të trajtojë konceptin e juridiksionit, sipas legjislacionit dhe praktikës gjyqësore shqiptare, si dhe mosmarrëveshjet që kanë lindur në praktikë për përcaktimin e juridiksionit gjyqësor dhe administrativ. Në këtë punim do të trajtohet kuptimi i juridiksionit, duke referuar në legjislacionin e shtetit Shqiptar, llojet e juridiksionit, mosmarrëveshjet e juridiksionit. Më poshtë do të trajtohen çështjet që gjykata nuk ka juridiksion për t'i gjykuar, pasi mungesa e juridiksionit lidhet me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës (aksesit në drejtësi). Në punim do të trajtohet juridiksioni në këndvështrimin e Kodit të Procedurës Civile të Shqipërisë, ligjit Nr.49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Kodin e Procedurave Administrative të Shqipërisë shoqëruar me praktikë gjyqësore. Punimi do të pasurohet me praktikë të Gjykatës së Lartë (vendime unifikuese dhe vendime të kolegjit civil dhe administrativ), praktikë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Gjatë punimit do të ngrihen probleme juridike si dhe qëndrime të ndryshme të konstatuara në praktikë. Në përfundim të punimit do të jepen konkluzione për këto interpretime të ndryshme të rasteve në praktikë, si dhe rekomandime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin shqiptar.*

**Fjalët kyç:** Juridiksion, administrativ, gjyqësor, procedurë, mosmarrëveshje, akses.

## **1 Kuptimi i Juridiksionit.**

Fjala juridiksion rrjedh nga latinishtja *jus dicere* që do të thotë të deklaroj ligjin dhe përdorej për të përcaktuar pushtetin që kishte një gjykatë për të interpretuar dhe zbatuar ligjin. Përkufizimin e termit juridiksion e ka dhënë teoria e së drejtës procedurale civile. Për të kuptuar më qartë kuptimin e juridiksionit po japim disa përkufizime sipas literaturës të së drejtës procedurale civile shqiptare në vite:

*"E drejta e organeve shtetërore për të zgjidhur çështjet që përfshihen në funksionet e tyre, duke zbatuar në çdo rast ligjën quhet juridiksion (jus dicere).<sup>1</sup>*

---

\* Kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

<sup>1</sup> Alqiviadh Lamani, *Procedura Civile* (1961), në 62.

*“Rrethi i çështjeve që i takon të zgjidhë, në bazë të ligjit, njërit ose tjetrit organ shtetëror quhet juridiksion”.<sup>2</sup>*

*“Juridiksioni është e drejta e një organi për të ushtruar një veprimtari të caktuar në përputhje me ligjin, domethënë rrethi i çështjeve që i takon të zgjidhë në bazë të ligjit njëri ose tjetri organ”.<sup>3</sup>*

Nga përkufizimet e mësipërme rezulton se juridiksioni trajtohet si një e drejtë që kanë organet shtetërore për të zgjidhur çështjet që i takojnë atyre në bazë të ligjit. Juridiksioni si nocion juridik përfshin ndarjen e punëve midis organeve shtetërore. Pra zgjidhja e një mosmarrëveshje të caktuar përcaktohet me ligj nëse do ta zgjidhë një organ i administratës publike apo gjykata.

Në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: “Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod (siç janë mosmarrëveshjet tregtare etj.) e në ligje të veçanta”.

Pra siç konstatohet Kodi i Procedurës Civile nuk jep një përkufizim të qartë se çfarë do të kuptojmë me juridiksion, por nga përmbajtja e kësaj norme juridike mund të nxjerrim kuptimin e juridiksionit. Sipas nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile rezulton se gjykata ka të drejtë të shqyrtojë vetëm ato mosmarrëveshje të cilat ia lënë asaj për shqyrtim në bazë të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjeve të veçanta.

Përpara fillimit të funksionimit të Gjykatave Administrative, çështjet administrative në zbatim të nenit 320 të Kodit të Procedurës Civile gjykoheshin nga seksioni administrativ i Gjykatës së Shkallës së Parë. Rregullat për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative përcaktoheshin në Titullin III, Kreu II, nenet 324-333 të Kodit të Procedurës Civile, duke u konsideruar shqyrtimi i këtyre çështjeve si gjykime të posaçme. Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, dhe me fillimin e funksionimit të Gjykatave Administrative më datë 04.11.2013, nenet 324-333 të Kodit të Procedurës Civile u shfuqizuan pasi rregullat për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe përcaktimin e juridiksionit për këto çështje u përcaktuan pikërisht nga ky ligj.

Është për tu theksuar se neni 1/2 i ligjit ka lejuar Gjykatën Administrative që për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative të zbatojë dhe parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Në qoftë se një gjykatë i mungon juridiksioni mbi një kategori të caktuar çështjesh ajo është e pafuqishme që të shqyrtojë këto kategori çështjesh dhe të

<sup>2</sup> Vahid Lama, *E Drejta Procedurale Civile Shqiptare*, Dispenca I (1974), në 86.

<sup>3</sup> Stavri Ceco, Ylber Maldini, Safet Hasani, *E Drejta Procedurale Civile* (1989), në 129.

vendosë për to, p.sh rasti kur gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar një çështje, është kur vetë palët kanë përcaktuar me marrëveshje me shkrim se në rast mosmarrëveshje midis tyre për zbatimin e kontratës, do t'i nënshtrohen procedurës së arbitrazhit.<sup>4</sup>

Çështja e përcaktimit të juridiksionit nga gjykata nëse një çështje bën pjesë apo jo në juridiksionin gjyqësor lidhet ngushtë me të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës e parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për të kërkuar rivendosjen e një të drejte të shkelur apo të cënuar. Prandaj trajtimi i konceptit të juridiksionit gjyqësor paraqet një rëndësi për të drejtën procedurale civile.

Sipas të drejtës procedurale civile të shtetit të Kosovës termi juridiksion që përdor legjislacioni shqiptar njihet me termin kompetencë absolute. Kompetenca absolute është e drejta e gjykatave vendase që të gjykojnë çështje juridike të caktuara.<sup>5</sup>

## **2 Llojet e Juridiksionit.**

Në varësi të llojit të organeve shtetërore që janë ngarkuar me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve juridiksioni ndahet në juridiksion administrativ dhe në juridiksion gjyqësor.

Juridiksioni është administrativ kur sipas ligjit e drejta dhe detyra për të zgjidhur disa çështje i është njohur organeve të ndryshme shtetërore që nuk janë gjykata. Juridiksioni është gjyqësor kur sipas ligjit e drejta dhe detyra e shqyrtimit dhe e zgjidhjes së çështjeve u është caktuar gjykatave.

Juridiksioni gjyqësor sipas llojit të gjykatave që shqyrtojnë çështjet ndahet në juridiksion gjyqësor kushtetues i cili ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, juridiksion gjyqësor i përgjithshëm që ushtrohet nga gjykatat e zakonshme dhe juridiksion i veçantë që ushtrohet nga gjykatat e krijuara me ligj të veçantë.<sup>6</sup>

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka bërë dallimin midis juridiksionit gjyqësor kushtetues dhe juridiksionit gjyqësor të përgjithshëm. Në juridiksionin e përgjithshëm të gjykatave të zakonshme është interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave. Ndërsa në juridiksionin gjyqësor kushtetues është kontrolli kushtetues që bën Gjykata Kushtetuese ndaj vendimeve gjyqësore, duke u kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor.

---

<sup>4</sup> Neni 414 i Kodit të Procedurës Civile.

<sup>5</sup> *Shih*, Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale I* (Prishtinë 2006).

<sup>6</sup> Neni 135(2) i Kushtetutës. Ligji Nr. 49/2012.

Kështu Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka bërë dallimin e juridiksionit gjyqësor kushtetues me juridiksionin gjyqësor të gjykatave të zakonshme si më poshtë:

Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave Gjykata Kushtetuese ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme çenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja “f” e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues.<sup>7</sup>

Për kufijtë e gjykimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr. 5, datë 25.02.2013, është shprehur se do të jemi para cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor dhe në rastin kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

Juridiksioni gjyqësor sipas llojit të natyrës së çështjeve dhe ligjit që do të zbatohet ndahet në juridiksion gjyqësor penal dhe juridiksion gjyqësor civil.

Kemi juridiksionin gjyqësor penal kur çështjet që do të shqyrtohen janë penale dhe ligji i zbatueshëm është legjislacioni penal Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, apo ligje të tjera penale.

Me juridiksion gjyqësor civil kuptojmë rrethin e mosmarrëveshjeve të ndryshme civile që rrjedhin nga e drejta civile, e punës, familjare si dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile si tregtare, apo në ligje të veçanta.<sup>8</sup>

Duke interpretuar dhe nenin 42 të Kushtetutës në lidhje me nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile mund të konkludohet se juridiksioni gjyqësor civil ka për objekt marrëdhëniet juridike qoftë të natyrës private apo publike nga të cilat lindin të

<sup>7</sup> Gjykata Kushtetuese, Vendim Nr. 42, datë 07.07.2014.

<sup>8</sup> Neni 36 i Kodit të Procedurës Civile.

drejta subjektive dhe interesa të ligjshme në favor të mbajtësit të saj, ose e thënë në mënyrë të përmbledhur është juridiksioni mbi të drejtat, liritë dhe interesat Kushtetuese dhe ligjore dhe ka për objekt të tij specifik deklarin, garantimin dhe përmbushjen e të drejtave që i takojnë subjekteve në marrëdhëniet reciproke të tyre.<sup>9</sup>

### **3 Kundërshtimi i juridiksionit**

Gjykata në çdo rast konkret në bazë të ligjit vendos edhe kryesisht, nëse i takon apo jo për të shqyrtuar çështjen që i paraqitet për shqyrtim.

Sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ.

Gjykata për përcaktimin nëse ka juridiksion apo jo për gjykimin e një çështje administrative, në disa raste duhet të kryejë verifikime dhe jo të mjaftohet vetëm me faktin se organi administrativ më i lartë nuk e ka shqyrtuar ankimin, pra duhet të kryejë hetim gjyqësor. Gjykata duhet të verifikojë nëse ankimi është paraqitur në afat tek organi më i lartë administrativ, nëse është shoqëruar me dokumentat përkatëse.

Kështu Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues Nr.3, datë 12.02.2008 kanë unifikuar praktikën gjyqësore si më poshtë:

‘Nëse gjykatës i rezulton se ankimi administrativ është paraqitur jashtë afatit dhe/ose mungojnë dokumentet shoqëruese sipas nenit 55 të ligjit dhe ky është shkaku i mosshqyrtimit në themel të ankimit nga organi administrativ, gjykata vendos konform neneve 36 e 59 të K.Pr.Civile nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Në të kundërt, nëse gjykata konstaton se ankimi administrativ, ndryshe nga ç’pretendon organi administrativ, është ushtruar në afat dhe ka qënë i shoqëruar nga dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të ligjit, nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ.

Gjykata, siç theksuam më sipër, e nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi, për faj të tij, nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithëse organi administrativ e ka vënë në dijeni për të metat e ankimit). Nëse gjykatës i rezulton se jo për faj të paditësit (ankuesit) çështja nuk është shqyrtuar në themel nga organi administrativ, atëhere në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që

---

<sup>9</sup> Alban Brati, *Procedura Civile* (2008) në 53-54.

garantojnë një proces të rregullt ligjor, është e detyruar të shqyrtojë çështjen në themel, duke qënë ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e çështjes’.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë si kur gjykata vendos të nxjerrë çështjen jashtë juridiksonit ashtu dhe kur refuzon të nxjerrë çështjen jashtë juridiksonit gjyqësor mbi bazën e kërkesës së palës, mund të bëhet ankim i veçantë brenda 5 ditëve në Gjykatën e Lartë.<sup>10</sup> Ky afat ankimi fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit ose e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin pra të ngutshme.

Sipas nenit 9 të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, rezulton se edhe gjykata administrative në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksonit dhe dërgimin e akteve organit kompetent. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Afati i ankimit të veçantë në zbatim të nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile është 5 ditë, duke filluar përsëri ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit për palët që janë prezent dhe për palët që janë në mungesë nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Në ndryshim nga Kodi i Procedurës Civile, ky ligj ka përcaktuar për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë një afat 10 ditor nga marrja e akteve në Gjykatën e Lartë për tu shprehur në dhomë këshillimi, nëse çështja përfshihet ose jo në juridiksionin gjyqësor. Ky afat është në përputhje me qëllimin që synon ligji Nr. 49/2012 për shpejtimin e gjykimit të çështjeve administrative. Neni 59 i Kodit të Procedurës Civile nuk përcakton ndonjë afat konkret për Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar ankimin e veçantë kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për juridiksionin. Mendoj se në interpretim me analogji të nenit 63/2 të Kodit të Procedurës Civile i cili përcakton si afat 30 ditor të Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar ankimin kundër vendimit që ka shpallur moskompetencën, dhe për shqyrtimin e ankimit kundër vendimit të juridiksonit afati i shqyrtimit të ankimit nga Gjykata e Lartë është 30 ditë nga dita e ardhjes së çështjes.

Edhe në Gjykatën Administrative gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata administrative

<sup>10</sup> Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 686, datë 11.05.2000. Sipas këtij vendimi vetëm Gjykata e Lartë ka të drejtë që të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për juridiksionin dhe jo Gjykata e Apelit.

mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë, ose të kryejë veprime procedurale që nuk presin.

Vendimi i Gjykatës për të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor është një vendim jo përfundimtar pasi ky vendim i jep fund procesit gjyqësor pa e zgjidhur çështjen në themel dhe pa i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve lidhur me të drejtën materiale të pretenduar.

Vendimi i Gjykatës për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është një vendim i ndërmjetëm që jepet nga gjykata në seancë gjyqësore për t'iu përgjigjur kërimit të palëve në procesin gjyqësor.

Kundër të dyja vendimeve lejohet ankim i veçantë siç u sqarua dhe më lart në punim. Në këto kushte gjykata në zbatim të nenit 142 të Kushtetutës dhe neneve 310 dhe 316 të Kodit të Procedurës Civile ka detyrimin t'i arsyetojë këto vendime, në mënyrë që palët të bëjnë një ankim efektiv.

Në praktikë është konstatuar si problematikë fakti që kur gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, ajo ka vazhduar gjykimin e çështjes, dhe pse kundër këtij vendimi ka pasur ankim të veçantë, pra nuk e ka pezulluar atë si dhe nuk e ka arsyetuar vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Konkretisht Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.715 (59), datë 20.02.2014 është shprehur si më poshtë për arsyetimin e vendimit të ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes civile jashtë juridiksionit gjyqësor si dhe pezullimin e gjykimit:

'Kolegji Civil çmon se përderisa pala e paditur ka ankuar vendimin lidhur me juridiksionin, gjykata e faktit nuk mund të vazhdojë gjykimin për zgjidhjen e themelit të çështjes pa zgjidhur më parë nëse çështja që po gjykon i takon apo jo juridiksionit gjyqësor.

Prandaj nga gjykata nuk mund të kryhet asnjë veprim tjetër procedural, përveç atyre që nuk presin, pa u zgjidhur se cilit juridiksion i takon një mosmarrëveshje që i është shtruar për zgjidhje gjykatës (neni 60 i K.Pr.Civile). Vendimi në lidhje me juridiksionin, që nga pikëpamja formale procedurale përbën një vendim të ndërmjetëm (kur gjykata vendos mospranimin e kërkesës së palës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor), dhe një vendim jo përfundimtar (kur gjykata vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor), duhet të jetë i arsyetuar në përputhje me kërkesat e nenit 310 të K.Pr.Civile'.

Sipas nenit 60 të Kodit të Procedurës Civile kur një institucion shtetëror pretendon se mosmarrëveshja që ka pranuar gjykata për një shqyrtim hyn në juridiksionin administrativ, mosmarrëveshja zgjidhet nga Gjkata e Lartë me kërkesën e institucionit shtetëror ose të prokurorit. Ky nen është i zbatueshëm dhe për gjykatat administrative siç është sqaruar më lart në punim.

Në praktikë në disa raste neni 60 i Kodit të Procedurës Civile nuk është kuptuar drejt nga gjykatat. Konkretisht kur gjatë shqyrtimit gjyqësor një organ administrativ, i cili është palë e paditur në procesin gjyqësor i ka kërkuar gjykatës nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, gjykata e ka konsideruar një mosmarrëveshje për juridiksionin dhe pa u shprehur për këtë kërkesë, ka pezulluar gjykimin për t'u shprehur Gjkata e Lartë lidhur me këtë kërkesë me vendim për të përcaktuar juridiksionin nëse është administrativ apo gjyqësor.

Ky qëndrim i mbajtur në praktikë është i gabuar, pasi gjykata në këtë rast në zbatim të nenit 28 të Kodit të Procedurës Civile ka detyrimin të shprehet për kërkesën e bërë nga organi administrativ lidhur me mungesën e juridiksionit gjyqësor dhe pasi të vendosë për pranimin ose jo të kërkesës, kjo çështje mbi bazën e ankimit të palëve duhet të bëhet objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë dhe jo me kërkesë të gjykatës.

Konkretisht Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.754, datë 07.07.2009 ka sqaruar si më poshtë:

'Nga gjykimi rezulton se kërkesa për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është parashtruar nga pala e paditur në atë gjykim. Në rrethana të tilla, gjykata e faktit duhet të mbante parasysh dhe të zbatonte kërkesat e nenit 59 të K.Pr.Civile, dispozita e së cilës parashikon se gjykata, në çdo fazë e shkallë të gjykimit, kryesisht apo me kërkesën e palës ndërgjyqëse, merr në shqyrtim dhe vendos nëse çështja objekt gjykimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, apo atë administrativ.

Ndërsa dispozita e nenit 60 të K.Pr.Civile gjen zbatim vetëm në rastet kur një institucion shtetëror, që nuk është palë në gjykim, i parashtron gjykatës pretendimin se mosmarrëveshja që ka pranuar gjykata për shqyrtim hyn në juridiksionin administrativ. Në këtë rast, jo kryesisht, por vetëm me kërkesën me shkrim të këtij institucioni shtetëror apo të prokurorit, gjykata duhet të vendosë dërgimin e akteve Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me juridiksionin.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vendimin e saj duke zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 60 të K.Pr.Civile.

Kërkesën për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit e ka parashtruar i padituri dhe jo ndonjë institucion tjetër shtetëror që nuk është palë në atë

gjykim. Kjo gjykatë nuk ndodhet përpara ndonjë mosmarrëveshje të saj me një institucion shtetëror, që nuk është palë në gjykim, lidhur me juridiksionin gjyqësor apo administrativ për zgjidhjen e çështjes.

Prandaj, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit, ku ajo të shprehet sipas kërkesave e prapësimeve eventuale të palëve edhe lidhur me faktin nëse shqyrtimi i çështjes bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ'.

#### **4 Çështjet Civile që nuk bëjnë Pjesë në Juridiksionin Gjyqësor**

Nga interpretimi i nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile arrijmë në konkluzionin që si rregull mosmarrëveshjet civile i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor. Përfundimisht nga rregulli mosmarrëveshjet civile nuk i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor.

Mosmarrëveshjet administrative në disa raste i nënshtrohen drejtëpërsëdrejti juridiksionit gjyqësor dhe në disa raste mosmarrëveshjet administrative i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor pasi shterohet rruga administrative.

Në Kodin e Procedurës Civile si dhe në disa ligje të posaçme përcaktohet se disa mosmarrëveshje edhe pse janë civile apo administrative nuk i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor.

Më poshtë do të sqarojme disa çështje civile që nuk i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor për shkak të imunitetit të personave, marrëveshjeve ndërkombëtare, apo natyrës së çështjes.

##### ***4.1 Kufizimi i juridiksionit gjyqësor shqiptar kundrejt subjekteve të huaja që gëzojnë imunitet diplomatik.***

Nuk i nënshtrohen juridiksionit civil shqiptar përfaqësitë konsullore dhe diplomatike, apo përfaqësuesit e shteteve të huaja gjatë kohës që qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si të ftuar nga shteti shqiptar. Këto përfaqësi apo përfaqësues shtetesh nuk mund të paditen në gjykatë pasi gëzojnë imunitet, i cili është respektuar qysh prej shekullit XVIII sipas të drejtës ndërkombëtare.

Në nenin 39 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet juridiksioni ndaj përfaqësive diplomatike dhe konsullore. Sipas këtij neni anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare pasi këta persona kanë imunitet.

Në këtë nen janë përcaktuar dhe rastet përjashtimore kur përfaqësitë diplomatike apo konsullore të huaja i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor shqiptar. Këto raste janë:

1. Kur këto përfaqësi pranojnë vullnetarisht juridiksionin gjyqësor civil shqiptar, pra heqin dorë nga imuniteti;
2. kur ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike.<sup>11</sup>

Sipas Konventës së Vjenës rezulton se imuniteti i juridiksionit civil i përfaqësuesve diplomatikë ose konsullorë të huaj nuk zbatohet në këto tre raste:

1. Për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e Shtetit pritës, përveç kur agjenti diplomatik e posedon atë për llogari të Shtetit akreditues për qëllimet e misionit;
2. për një veprim lidhur me një trashëgimi në të cilin agjenti diplomatik figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar ose legatar, si privat dhe jo në emër të Shtetit akreditues;
3. për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet tregtar çfarëdo qoftë, të ushtruar nga agjenti diplomatik në Shtetin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare.

Sipas nenit 40 të Kodit të Procedurës Civile rezulton se juridiksioni civil i gjykatave shqiptare nuk shtrihet në përfaqësuesit e shteteve të tjera dhe në grupin e tyre të shoqërimit, kur ata qëndrojnë me ftesë zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Pra në rastin konkret përfaqësuesit e shteteve të huaja kanë imunitet dhe nuk mund të paditen në gjykatat shqiptare.

Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj ka sqaruar se e drejta për akses në gjykatë, mund t'i nënshtrohet kufizimeve, shtetet kontraktuese gëzojnë një shkallë të caktuar vlerësimi megjithëse i takon gjykatës për të vendosur përfundimisht nëse janë respektuar kërkesat e Konventës. Kjo gjykatë ka konstatuar se imuniteti sovran është një koncept i së drejtës ndërkombëtare, dalë nga parimi *par in parem non habet imperium*, me anë të të cilit një shtet nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit të një shteti tjetër. Njohja e imunitetit Sovran për një shtet në proceset civile përmbush qëllimin legjitim të pajtimit me të drejtën ndërkombëtare për të përkrahur sjelljen e njerëzishme dhe marrëdhëniet e mira mes shteteve, nëpërmjet respektimit të sovranitetit të shtetit tjetër. Gjithashtu gjykata thekson se kufizimi duhet të jetë në propocion me qëllimin e ndjekur. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut aq sa është e mundur duhet

---

<sup>11</sup> Neni 31 i Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike nënshkruar më 18 Prill 1961, ratifikuar nga shteti shqiptar më datë 18 Shkurt 1988.

të interpretohet në harmoni me rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare pjesë e së cilës është imuniteti shtetëror.<sup>12</sup>

Një diskutim që ka lindur në praktikë është rasti i marrëdhënieve të punës, pra personat e punësuar pranë përfaqësisë diplomatike apo konsullore në rast se i zgjidhet kontrata e punës në mënyrë të njëanshme apo kanë pretendime lidhur me kontratën e punës a mund t'i drejtohen juridiksionit gjyqësor civil të shtetit ku ndodhet përfaqësia diplomatike apo konsullore?

Në çështjen *Fogarty kundër Mbretërisë së Bashkuar* (këkesa Nr.37112/97), datë 21 Nëntor 2011, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se duket të ketë një tendencë të përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare dhe të krahasuar që synon drejt kufizimit të imunitetit shtetëror në raport me mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë marrëdhëniet e punës. Në rastin kur procesi ka të bëjë me punësimin në një mission të huaj ose një ambasadë, praktika ndërkombëtare është e ndarë në lidhje me pyetjen nëse imuniteti shtetëror gjen zbatim në këtë plan dhe nëse po imuniteti shtetëror shtrihej në mosmarrëveshjet që kishin të bënin me të gjitha kontratat e punës të stafit të përfaqësisë së huaj apo vetëm me personelin e lartë të misionit?

Megjithatë Gjykata në këtë rast i njohu imunitetin Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke arritur në konkluzionin që Mbretëria e Bashkuar kishte vlerësuar drejt hapësirën e vlerësimit që u lejohet shteteve në kufizimin e së drejtës të individëve për t'u drejtuar gjykatave. Pra Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, i ka dhënë hapësirë shteteve që të vlerësojnë imunitetin shtetëror.

Në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.8, datë 10.06.2011 kanë unifikuar praktikën gjyqësore shqiptare përsa i përket kufizimit të juridiksionit gjyqësor civil shqiptar për marrëdhëniet e punës. Konkretisht Kolegjet e Bashkuara kanë unifikuar praktikën shqiptare si më poshtë:

'Kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, sipas Marrëveshjes Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.06.1992, janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pavarësisht nga ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga këto marrëdhënie...

Nëse në kontratat e punësimit të lidhura midis subjekteve të mësipërme me cilësinë e punëdhënësve dhe punëmarrësve shqiptarë është përcaktuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të marrëdhënies së punës

---

<sup>12</sup> Shih vendimin *Nikolaus dhe Jurgen Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë*.

palët mund t'i drejtohen gjykatës shqiptare, një gjë e tillë do të konsiderohet si pranim vullnetar i juridiksionit të gjykatave shqiptare, në kuptim të nenit 39/a të K.Pr.Civile’.

Pra siç konstatohet legjislacioni dhe jurisprudenca e Republikës së Shqipërisë e respekton parimin e imunitetin shtetëror të së drejtës ndërkombëtare, duke pranuar kufizimin e juridiksionit gjyqësor civil për këtë arsye.

Po kështu Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.2304 (569), datë 13.12.2011 është shprehur për mungesën e juridiksionit civil shqiptar si më poshtë:

‘Në analizë të Konventës Konsullore nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr.7606, datë 15.09.1992; Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (1963), ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr.9105, datë 17.07.2003, nenit 39/a të K.Pr.Civile, rezulton se Konsullata Greke në Korçë gëzon imunitet për të mos iu nënshtruar juridiksionit shqiptar për çështjen objekt shqyrtimi gjyqësor’.

#### ***4.2 Kufizimi i juridiksionit shqiptar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me element të huaj.***

Në nenin 37 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: “Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juidrikë të huaj rregullohet me ligj”.

Ligji që rregullon juridiksionin gjyqësor civil të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet me element të huaj është ligji Nr. 10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Ky ligj në Kreun e IX, në nenet 71 - 81, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar duke marrë për bazë natyrën e mosmarrëveshjes civile, juridiksionin dhe rregullat procedurale të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaja.

Sipas nenit 37/2 të Kodit të Procedurës Civile juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj. Po ky nen ka parashikuar dy kushte të cilat duhet të plotësohen së bashku ku juridiksioni i gjykatave shqiptare mund t'i kaloj një juridiksioni të huaj. Këto kushte janë:

- Kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji dhe një shtetasi shqiptar, ose personi juridik është pa banim ose qëndrim në Shqipëri si dhe
- kur përjashtimi i juridiksionit gjyqësor shqiptar është parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Në nenin 38 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se Gjykata shqiptare nuk pushon as pezullon gjykimin e një mosmarrëveshje, kur kjo e fundit ose një çështje tjetër që ka lidhje me të është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Kështu Gjykata e Lartë me vendimin Nr.1269 (172), datë 24.04.2014, ka lënë në fuqi vendimin Nr. 2737 Akti, datë 26.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare, duke argumentuar si më poshtë:

‘Në nenin 38, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet shprehimisht se: “Gjykata shqiptare nuk pushon as pezullon gjykimin e një mosmarrëveshjeje, kur kjo e fundit ose një çështje tjetër që ka lidhje me të, është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj.” Në analizë të kësaj dispozite, vlerësohet se Gjykata Shqiptare nuk kanë detyrimin për të pezulluar ose pushuar një proces gjyqësor nëse është nisur të gjykohej pranë një gjykate të huaj.

Në të njëjtën kohë, Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.109/2012 ka ratifikuar “Konventën mbi njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore”, ku në nenin 12 të saj parashikohet se: “Procedimi për divorc ose ndarje ligjore i filluar në një Shtet Kontraktues mund të pezullohet, kur procedimi në lidhje me statusin martesor të dy palëve është në pritje të zgjidhjes në një shtet tjetër kontraktues.” Nga interpretimi literal i kësaj dispozite, rezulton se kjo normë nuk ka karakter ndalues dhe nuk autorizon ndërprerjen e procesit gjyqësor, të iniciuar përpara gjykatës shqiptare as duke pushuar gjykimin as duke pezulluar atë, për shkak se palët e kanë çuar të njëjtën mosmarrëveshje para një gjykate të huaj e cila eventualisht mund të jetë shpallur kompetente, por është lënë si alternativë e mundshme, nga ana e gjykatës në varësi të çështjes gjyqësore që është duke u gjykuar pranë Gjykatës Shqiptare’.

## **5 Mosmarrëveshjet civile ku palët kanë zgjedhur për zgjidhjen e tyre procedurën e arbitrazhit**

Në qoftë se palët kanë bërë një marrëveshje midis tyre që të gjitha mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur midis tyre ia nënshtrojnë arbitrazhit, asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë që të shqyrtojë këto mosmarrëveshje.

Kur një mosmarrëveshje që është duke u shqyrtuar nga një gjykatë arbitrazhi, mbi bazën e një marrëveshje arbitrazhi, i dërgohet për gjykim një juridiksioni tjetër, ky i fundit duhet të deklarojë moskompetencën.

Kur procedura e arbitrazhit për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ende nuk ka filluar, juridiksioni tjetër duhet gjithashtu të deklarojë moskompetencën, përveç kur marrëveshja e arbitrazhit është haptazi e pavlefshme.<sup>13</sup>

Nga interpretimi i nenit 414 të Kodit të Procedurës Civile rezulton se marrëveshja e palëve për nënshtrimin e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve një gjykate arbitrazhi është thelbësore në përcaktimin e juridiksionit. Dhe asnjë institucion tjetër qoftë edhe gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim këtë mosmarrëveshje, por duhet të deklarojë mungesën e juridiksionit. Në nenin 414 është përdorur termi moskompetencë dhe jo mungesë juridiksioni. Mendoj se pavarësisht se ky nen ka përdorur termin moskompetencë bëhet fjalë për mungesën e juridiksionit për shqyrtimin e çështjes dhe ky është një lapsus apo gabim teknik i ligjit.

Nga interpretimi i nenit 402 të Kodit të Procedurës Civile rezulton se objekt gjykimi arbitrazhi është çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore. Nuk mund të jenë objekt arbitrazhi çështjet që lidhen me të miturit dhe me familjen si dhe çështjet administrative. Në rast se ka marrëveshje për të zgjidhur mosmarrëveshjet nga një gjykatë arbitrazhi për çështjet familjare apo administrative kjo marrëveshje është e pavlefshme dhe gjykata duhet që këto çështje t'ia nënshtrojë shqyrtimit gjyqësor në zbatim të nenit 414 të Kodit të Procerurës Civile.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimet Nr. 140, datë 17.01.2008 dhe Nr.806, datë 17.06.2008 ka lënë në fuqi vendimet e Gjykatave të Shkallës së Parë të cilat kanë nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështjet civile me arsyetimin se palët në gjykim me marrëveshje ndërmjet tyre kanë përcaktuar që për zgjidhjen e konflikteve do t'i zgjidhin nëpërmjet arbitrazhit.

Kështu Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 806 është shprehur si më poshtë:

'Nga tërësia e atyre që cituam më lart rezulton qartë se palët kanë rënë dakord t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me procedurë arbitrazhi. Me të drejtë gjykata arsyeton se një gjë e tillë është e lejuar nga neni 403 i K.Pr.Civile, i cili parashikon: "Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm n.q.s. ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të të cilës ato pranojnë t'ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose që mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre". Në rast të një marrëveshje të tillë ligjvënësi ka bërë rregullimin e parashikuar në nenin 414 të K.Pr.Civile, të cilin ka zbatuar edhe gjykata. Ne paragrafin 2 të kësaj dispozite parashikohet: "Kur procedura e arbitrazhit për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ende nuk ka filluar, juridiksioni tjetër duhet gjithashtu të deklarojë moskompetencën, përveçse

<sup>13</sup> Neni 414 i Kodit të Procedurës Civile.

kur marrëveshja e arbitrazhit është haptazi e pavlefshme”. Meqenëse nuk ka patur asnjë pretendim për pavlefshmëri të marrëveshjes dhe as nuk rezulton që ajo të jetë haptazi e tillë, arrihet në konkluzionin se vendimi i gjykatës është i drejtë e i bazuar’.

## **6 Problemet që kanë Lindur në Praktikë në Lidhje MJuridiksionin Gjyqësor Administrativ dhe të Rejat që Sjell Ligji Nr. 49/2012, Datë 03.05.2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.**

### **6.1 Aktet administrative që nuk i nënshtrohen juridiksionit gjyqësor.**

Ligji Nr. 49/2012, datë 03.05.2012, për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në nenin 8 të tij ka përcaktuar rrethin e mosmarrëveshjeve që nuk shqyrton gjykata administrative. Përpara se të trajtojmë nenin 8 të këtij ligji, po sqarojmë rregullimin e mëparshëm legjislativ të mosmarrëveshjeve administrative që nuk shqyrtoheshin nga gjykata.

Në nenin 326 të Kodit të Procedurës Civile<sup>14</sup> përcaktohej në mënyrë taksative se nuk mund të ngrihet padi në gjykatë në këto raste:

- a) aktet administrative të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës publike të nivelit qendror ose vendor që kanë karakter normativ, përveç kur ato çënojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe interesa të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë; aktet administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë; aktet administrative të cilat sipas Kushtetutës janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.

Sipas interpretimeve doktrinale dhe gjyqësore që i janë bërë gërmës “a” të nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile ka rezultuar se aktet administrative normative nuk ishin objekt shqyrtimi të gjykatave të zakonshme, por këto gjykata kishin si objekt shqyrtimi vetëm aktet administrative me karakter individual. Por ka edhe akte individuale që vetë Kushtetuta i ka lënë në juridiksion të Gjykatës Kushtetuese dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga gjykata e zakonshme sipas gërmës “c” të nenit 326 të K.Pr.Civile p.sh. neni 115 i Kushtetutës përcakton se akti administrativ i Këshillit të Ministrave që shkarkon apo shpërndan organin e zgjedhur të njësisë së qeverisjes vendore ankimohet në Gjykatë Kushtetuese.<sup>15</sup>

---

<sup>14</sup> Ky nen është shfuqizuar me ligjin Nr. 49/2012, datë 03.05.2012.

<sup>15</sup> Sokol Sadushi, *E Drejta Administrative 2*, botimi i tretë (Ora, 2005), në 265.

Përsa i përket akteve administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë parashikuar nga gërma “b” e nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile, praktika dhe doktrina shqiptare ka mbajtur qëndrime të ndryshme.

Një çështje shumë e diskutuar në praktikën gjyqësore ka qenë nëse ligjshmëria e shkarkimit të anëtarit të Këshillit të Qarkut është objekt shqyrtimi nga gjykatat e zakonshme apo anëtari i Këshillit të Qarkut është një funksionar publik sipas nenit 326 gërma “b” të Kodit të Procedurës Civile?

Kështu Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues të praktikës gjyqësore Nr.5, datë 03.03.2006 i cili është i detyrueshëm për t`u zbatuar nga gjykatat janë shprehur si më poshtë për kundërshtimin e mbarimit të mandatit të anëtarëve të këshillit të qarkut:

‘Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se mbarimi i mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut për shkak të heqjes së tij nga këshilli bashkiak përkatës, bazuar në nenin 52/3 (b) të Ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, nuk përbën lëndë për shqyrtimin e konfliktit në rrugë gjyqësore.

.... Megjithatë, vendimet e këshillave bashkiake apo komunale për zgjedhjen e anëtarëve që do t`i përfaqësojnë në këshillin e qarkut dhe ato për heqjen e mandatit të përfaqësimit në këtë këshill konsiderohen akte administrative individuale të një natyre të veçantë, sepse ato nuk janë akte që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike me të tretët, por akte që rregullojnë konstituimin, organizimin dhe funksionimin e brendshëm të këshillit të qarkut në bazë të rregullit të përfaqësimit përpjestimor të subjekteve politike, të zgjedhurit e të cilave kanë konstituuar këshillin bashkiak apo komunal përkatës.

Në këndvështrimin e shumicës së anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk vërehet ndonjë kontradikte midis përmbajtjes së nenit 18 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 326 të K.Pr.Civile. Të zgjedhurve si përfaqësues në Këshillin e qarkut nëpërmjet shkarkimit nga kjo detyrë në zbatim të kriterëve të parashikuara në ligjin për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore, nuk u shkelet ndonjë e drejtë kushtetuese apo e drejtë e mbrojtur me ligj. Nga ana tjetër, këta persona të zgjedhur nuk konsiderohen persona privatë e nuk përfitojnë të drejta si të tillë, por ata janë funksionarë publikë, veprimtaria e të cilëve i nënshtrohet një regjimi juridik të posaçëm, i cili përjashton rrugën gjyqësore të shqyrtimit të konflikteve të lindura gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie’.

Në ndryshim nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin Nr.10, datë 11.05.2006, ka arritur në konkluzionin se aktet individuale për shkarkimin e anëtarit të këshillit të qarkut janë objekt shqyrtimi gjyqësor duke arsyetuar si më poshtë:

‘Shkarkimi i anëtarit të Këshillit të Qarkut nga Këshilli Bashkiak hyn në juridksionin gjyqësor ...

Juridiksioni gjyqësor në një shtet të së drejtës, nëpërmjet kontrollit të ligjshmërisë të akteve administrative, luan një rol të dukshëm e të rëndësishëm në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se nxjerrja e çështjes jashtë juridksionit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, është e padrejtë dhe ka prekur standartet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e mohimit të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, pra të përjashtimit të vetë procesit gjyqësor’.

Sipas të drejtës Kushtetuese në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*)<sup>16</sup>. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh faktin se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë pjesë integrale e Kushtetutës, si burimi kryesor i së drejtës që qëndron në krye të hierarkisë së normave juridike, ato (*vendimet e Gjykatës Kushtetuese*) kanë përparësi ndaj atyre burimeve të së drejtës (*ligj, akte nënligjore, e në këtë kuptim edhe vendimet unifikuese të cilat kanë si qëllim interpretimin e drejtë dhe unifikimin e ligjit material dhe procedural*) të cilët në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës janë në hierarki më poshtë se Kushtetuta apo Vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë këndvështrim, duke qënë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese në hierarkinë e normave juridike si burime të së drejtës ka fuqi më të lartë se vendimi unifikues i cili del për unifikimin dhe zbatimin në mënyrë të drejtë të ligjit procedural dhe material, gjykata është e detyruar që në një kolizion të tillë qëndrimesh të zbatojë vendimin Nr. 10 datë 11.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese duke konkluduar se çështja objekt gjykimi hyn në juridksionin gjyqësor.<sup>17</sup>

Ligji Nr. 49/2012, ka përcaktuar në nenin 8 të tij se cilat lloj mosmarrëveshje nuk shqyrtohen nga gjykata administrative. Konkretisht në këtë nen përcaktohet se:

“Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet:

---

Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 2 datë 03.02.2010.

<sup>17</sup> Të njëjtin qëndrim mban dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr.537, datë 06.02.2014.

- a) të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e gjykatës Kushtetuese.
- b) shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e gjykatës tjetër.”

Pra konstatohet se gërma “a” e këtij neni ka të njëjtin formulim si ish neni 326 germa “c” i Kodit të Procedurës Civile, ku aktet nënligjore normative që sipas Kushtetutës janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të shqyrtohen nga gjykata administrative.

Kurse germa “b” e këtij neni ka të bëjë me kompetencën funksionale dhe lëndore të gjykatës administrative në raport me gjykatat e zakonshme.

Ligji Nr.49/2012, ka sjellë si risi rritjen e kontrollit nga gjykata administrative të llojit të akteve administrative, duke përcaktuar objekt shqyrtimi gjyqësor dhe aktet administrative me karakter normativ.<sup>18</sup> Pra ky ligj i ka dhënë zgjidhje një sërë çështjesh shumë të debatueshme në lidhje me përcaktimin e juridiksionit për shqyrtimin e çështjeve me objekt kundërshtimin e akteve administrative me karakter normativ, duke i vendosur këto mosmarrëveshje në kompetencë lëndore të gjykatës administrative të apelit. Ky përcaktim ligjor ka shmangur plotësisht debatet në lidhje me rregullin e moskundërshtimit të akteve normative në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe në lidhje me interpretimin e përjashtimit nga ky rregull.<sup>19</sup> Kjo risi është në përputhje me Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të KE Rek. 2004 (20) mbështetet tek parimi se të gjitha aktet administrative duhet t’u nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor dhe rekomandon një numër të vogël përjashtimesh, të cilat janë të përcaktuara në bazë të ligjit, për disa akte administrative, kryesisht në fushën e punëve të jashtme, marrëveshjeve ndërkombëtare, në fushën e mbrojtjes ose sigurisë kombëtare. Ky rekomandim përfshin *akte individuale administrative*, që formojnë vendime të marra nga administrata për individë të caktuar dhe *rregullore të përgjithshme jo-personale*, që i drejtohen një numri të pacaktuar individësh. Më tej, përfshin *veprime materiale* që do të kenë pasoja në kuptimin e rregullave ligjore që qeverisin personat fizik apo juridik, dhe së fundmi, përkufizimi gjithashtu përfshin *situatat e refuzimit apo mosveprimit* nga ana e administratës publike në ato raste kur autoriteti administrativ e ka për detyrë të veprojë.<sup>20</sup>

Një çështje që mbetet për diskutim janë aktet administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë nëse janë objekt shqyrtimi nga gjykata administrative. Ligji i ri Nr. 49/2012, në

<sup>18</sup> Shih nenet 7, 10/2, 12/2, 15 gërma “d” të ligjit 49/2012.

<sup>19</sup> Sokol Sadushi, *E Drejta Administrative 2*, në 267-275.

<sup>20</sup> Memorandum Shpjegues për Rekomandimin Rec. 2004.

ndryshim nga neni 326 gërma “b” e Kodit të Procedurës Civile i shfuqizuar nuk përcakton se aktet administrative që lidhen me emërimin e dhe shkarkimin e funksionarëve publikë nuk mund të ankohen në gjykatë.

Në këto kushte ky ligj nuk i kufizon të drejtën në mënyrë të shprehur funksionarëve publikë për t'iu drejtuar gjykatës administrative në lidhje me emërimin apo shkarkimin e tyre nga detyra. Gjykata në përcaktimin e juridiksionit në këto raste duhet të referojë në ligjin e posaçëm rast pas rasti që rregullon funksionarin publik.

Një rast të parashikimit në një ligj të veçantë, e gjejmë në nenin 30/2 të ligjit Nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” ku përcaktohet se: ‘Subjektet që gëzojnë statusin e funksionarit politik, nuk kanë të drejtë të paraqesin ankim kundër aktit të ministrit ose drejtuesit të institucionit qëndror në varësi të Kryeministrit, me pretendimin se u është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm’. Pra ky ligj ka përcaktuar kategorinë e funksionarëve politikë të cilët nuk kanë të drejtë të ankimojnë emërimin apo shkarkimin e tyre nga detyra në gjykatë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen me Nr.28541/95, datë 08.12.1999, “*Pelegrin kundër Francës*” është shprehur se kriteri që do të përcaktojë nëse një mosmarrëveshje do të përjashtohet apo jo nga objekti i nenit 6/1 të Konventës është kriteri “funksional”, i bazuar në natyrën e detyrimeve dhe përgjegjësisive e të punësuarve.

Gjykata theksoi se të vetmet mosmarrëveshje që përjashtohen nga objekti i nenit 6/1 i Konventës ishin ato që kishin të bënin me pretendimet e ngritura nga funksionarët publikë kur këta shërbejnë si mbajtës të autoritetit publik dhe janë përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit ose të autoriteteve të tjera publike.

## **6.2 Kushti për shterimin e ankimit administrativ.**

Në nenin 16 të ligjit Nr. 49/2012 përcaktohet rregulli se padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.

Si përjashtim nga rregulli ky nen përcakton rastet kur padia ndaj veprimit administrativ ngrihet drejtpërdrejt në gjykatë. Këto raste janë:

- ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë nuk është konstituuar;
- ligji parashikon shprehimisht të drejtën për tu ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;

- organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cënuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personal të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.

Ky nen në ndryshim nga përcaktimi që bënte neni 328<sup>21</sup> i Kodit të Procedurës Civile ka përcaktuar në mënyrë të detajuar rastet se kur mund të ngrihet padi drejtpërsëdrejti në gjykatë kundër një veprimi administrativ.<sup>22</sup>

Nga interpretimi doktrinal dhe gjyqësor konstatohet se krahas tre rasteve të trajtuara më sipër sipas nenit 16 të ligjit Nr. 49/2012, juridiksioni i drejtpërdrejtë gjyqësor, mund të përcaktohet edhe nga natyra e çështjes (e shprehur në objektin e padisë). Kështu, në rastin kur kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ, çdo subjekt i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës, pa shteruar rrugën e ankimit administrativ. Ky përfundim rrjedh në radhë të parë nga natyra e veçantë që kanë aktet administrative, dhe njëkohësisht nga shkaqet e pavlefshmërisë absolute.

Kështu Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues Nr. 3, datë 12.02.2008, janë shprehur si më poshtë:

'[N]ëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërvaruar nga ndonjë afat parashkrimi, gjykata, nuk mund të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, por në zbatim të nenit 121 të K.Pr.Administrative dhe 331 të K.Pr.Civile, konstaton pavlefshmërinë për efekt të zgjidhjes së pasojave juridike që janë krijuar nga akti'.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr.49/2012 me vendimin Nr.217, datë 09.01.2014 ku është shprehur:

'Duhet vënë në dukje fakti se Gjykata e Lartë ka një qëndrim të konsoliduar në raste të tilla, pasi në shumë vendime të saj është mbajtur qëndrimi që, kur kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ juridiksioni gjyqësor nuk mungon, prandaj pala e interesuar mund t'i drejtohet direkt gjykatës pa qenë nevoja që më parë t'i drejtohet organit administrativ, por në këtë rast gjykata që shqyrton çështjen është e detyruar që të zbatojë me rigorozitet kërkesat e nenit 116 të K.Pr.Administrative, duke u mjaftuar vetëm me verifikimin e tre rasteve që parashikohen në të.

---

<sup>22</sup> Sipas nenit 2 pika 7 të ligjit Nr. 49/2012, "Veprim administrativ" është akti administrativ, kontrata administrative dhe veprimi tjetër administrativ.

Në rastin në gjykim gjykata e shkallës së parë ka zbatuar keq ligjin, pasi ajo i ka hyrë shqyrtimit në themel të çështjes pa u shprehur më parë në lidhje me juridiksionin. Hetimi gjyqësor i kryer prej saj dhe përfundimi i arritur kanë të bëjnë me themelin e çështjes’.

Në praktikën shqiptare janë konstatuar praktika të ndryshme gjyqësore, lidhur me faktin kur ligji është i paqartë për përcaktimin e juridiksionit, kujt duhet t’i drejtohet subjekti për cënimin e së drejtës apo interesit të ligjshëm të tij nga akti administrativ organit administrativ apo gjykatës?

Një nga rastet kur ligji është i paqartë lidhur me të drejtën e ankimit në rrugë administrative apo gjyqësore është neni 14 i ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, në të cilin përcaktohet se:

‘Kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tij’

Ky përcaktim ligjor ka sjellë qëndrime të ndryshme në praktikën gjyqësore lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor. Për këtë arsye Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues Nr. 1, datë 26.11.2010, kanë unifikuar praktikën për zbatimin e këtij neni duke ngritur dy probleme të rëndësishme:

1. A është e detyrueshme ndjekja paraprake e rrugës administrative të ankimit kundër vendimeve të dhëna nga inspektoriatet vendore ndërtimore e urbanistike. sipas dispozitës së nenit 14 të Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”?

2. Nëse po, cili është organi administrativ ku, sipas këtij ligji të posaçëm, duhet të drejtohet ankimi administrativ kundër vendimit të dhënë nga inspektorati vendor ndërtimor dhe urbanistik?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur duke unifikuar praktikën për këto dy çështje si më poshtë:

‘Ndekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t’i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se

ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ.

Përveç detyrueshmërisë së parashikimit të ndjekjes së rrugës administrative të ankimit, të organit ku ai drejtohet dhe që ka kompetencën për shqyrtimin e saj, eventualisht, sipas natyrës së marrëdhënieve juridike dhe asaj të mosmarrëveshjes, ligji i posaçëm mund të parashikojë ose jo edhe modalitete konkrete mbi afatet, kushtet e procedurat që duhen respektuar për të bërë të pranueshëm për shqyrtim në themel ankimin administrativ, për procedurat e shqyrtimit dhe natyrën e vendimmarrjes nga organi administrative, etj. Nëse rregulla të tilla eventuale nuk janë parashikuar, gjejnë zbatim afatet, kushtet e procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Edhe përsa i përket interpretimit dhe zbatimit të drejtë të dispozitave të Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, posaçërisht të dispozitës së nenit 14 të këtij ligji, nuk është e detyrueshme ndjekja e rrugës administrative të ankimit nga ana e individëve dhe personave juridike ndaj të cilëve inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor ka nxjerrë një vendim për marrje masash dhe dhënie sanksionesh administrative. Kjo dispozitë, përsa i përket ushtrimit të së drejtës për ankim administrativ dhe padi në rrugë gjyqësore, mbetet një norme me karakter thjesht deklarativ, duke mos treguar detyrueshmërinë e ndjekjes paraprake të rrugës administrative të ankimit, si dhe organet kompetente të ngarkuara me detyrimin për pranimin për shqyrtim dhe dhënien e vendimit përkatës’.

Një diskutim tjetër që është ngritur në praktikën gjyqësore është për çështjet me objekt kundërshtim njoftimi vlerësimi tatimor që konsiston në faktin nëse kamatëvonesat janë pjesë e detyrimit tatimor, në kuptim të pikës 1 të nenit 107 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe nëse po a janë pjesë e detyrimit tatimor, duhet të jenë të përcaktuara në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore, apo tatimpaguesi, duhet t’i llogarisë vetë ato dhe t’i paguajë, pavarësisht nëse njoftim vlerësimi tatimor i përmban si detyrim apo jo?

Në nenin 107 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjvënësi ka parashikuar pagesën e detyrueshme të detyrimit tatimor, detyrim i cili është objekt i ankimit:

1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore

2. Shuma e pagueshme, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjithë gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.
3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është subjekt i ankimit.
4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore’.

Sipas këtij neni pagesa e plotë e detyrimit që përmban njoftimi tatimor është kusht për shqyrtimin e ankimit në rrugë administrative dhe më pas gjyqësore.

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se organet tatimore janë organe administrative dhe veprimtaria e tyre, apo aktet që ato nxjerrin, nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për t’u përfshirë në kriteret dhe kushtet e nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

‘Gjykata çmon që Shtetet Kontraktuese duhet të jenë të lirë për t’i dhënë autoriteteve tatimore fuqinë, të vendosin ndëshkime të tilla si vlerësime në lidhje me taksat, edhe kur ato arrijnë në sasi të mëdha. Ky sistem nuk është në mospërputhje me Nenin 6 § 1, me kusht që tatimpaguesi mund të kundërshtojë, çdo lloj vendimi rreth tij, përpara një trupi gjyqësor që ka juridiksion të plotë, duke përfshirë fuqinë për të anuluar në çdo aspekt, të faktit dhe të ligjit, vendimin e kundërshtuar’.<sup>23</sup>

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur qëndrim të konsoliduar që, kundërvajtjet dhe mosmarrëveshjet civile të natyrës fiskale janë jashtë fushëveprimit të të drejtave dhe detyrimeve të një natyre civile, të parashikuara nga neni 6 i Konventës, pavarësisht nga efektet financiare, që ato prodhojnë për tatimpaguesin.<sup>24</sup>

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues Nr.4, datë 30.05.2011 lidhur me pagesën e kamatvonesave kanë konkluduar se:

‘Në rrethanat kur detyrimi tatimor në përgjithësi është i panegociueshëm, kur ai është i përcaktueshëm në çdo kohë nga subjekti tatimpagues, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arrijnë në vlerësimin unifikues se:

<sup>23</sup> *Bendenoun k. Francës*” datë 24 shkurt 1994 dhe “*Umlauf pushtet k. Austria* e 23 tetor 1995, Seria A nr.328-B.

<sup>24</sup> *Ferrazzini kundër Italisë*, [GC], n. 44759/98, publikuar në ECHR 2001- VII.

“Ilogaritja dhe pagimi i kamatëvonesave është detyrim vazhdues i subjektit tatimpagues, deri në çastin e përmbushjes së plotë të detyrimit kryesor...  
 “Tatimi i papaguar dhe kamatëvonesat e krijuara janë pjesë dhe përbëjnë detyrimin tatimor, i cili duhet të paguhet, përpara fillimit të procedurave të ankimit administrativ. Mospagimi i tyre përpara paraqitjes së ankimit administrativ, kundër Njoftim-Vlerësimit, passjell mos-shqyrtimin e kërkesës ankimore’.

Vlerësojmë se duhet bërë një dallim midis detyrimit që përcakton neni 107 i ligjit të sipërcituar për tu paguar plotësisht detyrimi përveç gjobave dhe detyrimi që mund të përcaktojë ligji për pagimin edhe të gjobës.

Në këtë drejtim në praktikën shqiptare ka dy vendime të Gjykatës Kushtetuese vendimet nr.18, datë 23.04.2010 dhe nr.16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese, ku kjo gjykatë ka shfuqizuar si antikushtetues ligjin për procedurat tatimore dhe nenin e Kodit Doganor të cilët përcaktonin si detyrim dhe pagimin e një pjesë të gjobës për akses në drejtësi. Sipas Gjykatës Kushtetuese.

Në praktikën shqiptare ka qëndrime të ndryshme përsa i përket faktit nëse kur organet tatimore aplikojnë gjobën ndaj subjekteve a është e nevojshme të ezaurohet rruga administrative apo subjekti mund të vij drejtpërdrejtë në gjykatë për shkak se dënimi me gjobë përcaktohet në rastet e kundërvajtjeve administrative?

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 1055, datë 28.01.2013, me shumicë votash ka vendosur që çështja administrative ankimi kundër njoftimit të dënimit me gjobë për kasen fiskale është në juridiksion gjyqësor pavarësisht se ankimi tek organi më i lartë administrativ është paraqitur jashtë afatit 30 ditor duke argumentuar se:

‘[L]idhur me aktet e nxjerra për konstatimin dhe caktimin e dënimit për veprime a mosveprime që përbëjnë kundërvajtje administrative sipas kreut XVI të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, vetë ky ligj i posaçëm nuk ka parashikuar rrugë, afate e procedura të detyrueshme ankimi administrativ të cilat duhet të ndiqen e respektohen nga kundërvajtësit, subjekte tatimpagues, apo persona të tjerë.

Nga ana tjetër, edhe ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në kreun III të tij, aty ku parashikohen rregullat mbi dënimet administrative me gjobë, nuk parashikon rrugë të detyrueshme administrative ankimi ndaj dënimit më gjobë, duke treguar shprehimisht se këto janë çështje që rregullohen rast pas rasti nga ligjet e posaçme. Nëse ligji i posaçëm nuk

kërkon ndjekjen e rrugës administrative, kundërvajtësi ka të drejtën t'i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës'<sup>25</sup>

Në këto rrethana vlerësojmë se Gjykata e Lartë duhet të unifikojë praktikën gjyqësore lidhur me këtë çështje.

## **7 Rekomandime**

1. Të përcaktohet në Kodin e Procedurës Civile afati për tu shprehur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për konfliktet e juridiksionit dhe ky afat të jetë në përputhje me ligjin Nr. 49/2012.
2. Të parashikohet në ligjin Nr.49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", juridiksioni për funksionarët publikë.
3. Të unifikohet praktika gjyqësore shqiptare në lidhje me juridiksionin gjyqësor për kundërvajtjet administrative në fushën e tatimeve, nëse duhet ndjekur rruga administrative apo jo.

---

<sup>25</sup> Të njëjtin qëndrim Gjykata e Lartë ka mbajtur në vendimin Nr.195, datë 14.05.2009. Qëndrim të kundërt ka mbajtur me vendimin Nr. 487, datë 08.11.2012.